



---

## **Metodologjia e Vlerësimit të Cilësisë së Kurrikulave për Trajnimin e Administratës Publike**

**[Dokument Pune]**

---

Titulli i Kurrikulës:

---

---

Vlerësoi:

---

[Emër Mbiemër, Pozicioni, Institucioni]

---

[Emër Mbiemër, Pozicioni, Institucioni]



<p>Kriteri 2.1: Përputhshmëria Ligjore</p>	<p><b>Kriteri i gjykit:</b></p> <p>Kurrikula duhet të sigurojë referencë me kuadrin ligjor që rregullon fushën, si dhe me ligje të tjera referuese.</p> <p>Duke vlerësuar kurrikulën lidhur me përputhshmërinë ligjore, sigurojmë koherencë të përmbajtjes së kurrikulës me standartet e përcaktuara në bazën ligjore.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ofron kurrikula referencë/pasqyrim të parimeve dhe klauzolave kryesore të kuadrit ligjor në fuqi?</li> <li>2. Ofron kurrikula lidhje apo referencë me ligje të tjera (lidhje direkte/ose që kanë një ndikim të tërthortë) në fushën e mbuluar nga kurrikula?</li> <li>3. Përputhen objektivat e kurrikulës me standartet e përcaktuara në kuadrin ligjor?</li> </ol>	
<p>Konkluzione dhe Rekomandime:</p>		

<b>Standarti 3: Krijimi i ekspertizës</b>		
<p><b>Kriteri 3.1</b> Kurrikula krijon ekspertizë në fushën përkatëse. Trainim fillestar/ i thelluar/i vazhdueshëm/ trajnim me teme të vecantë (specifik).</p> <p><b>Kriteri 3.2:</b> Kurrikula mundëson zhvillimin e karrierës brenda ose jashtë institucionit (në kontekste të ndryshme).</p> <p><b>Kriteri 3.3</b> Kurrikula mundëson udhëheqje (“leadership”) të fortë profesional (<i>opsional</i>).</p>	<p>Kurrikula duhet të sigurojë ekspertizë të thelluar në fushën përkatëse. Programi i kurrikulës duhet të mundësojë zhvillimin e njohurive në dy nivele: i. nivel bazë dhe ii. nivel të avancuar.</p> <p>Programi i kurrikules duhet të identifikojë qartë se cilat janë modulet (pjesë e programit të trajnimit bazë dhe cilat module i përkasin trajnimit të avancuar.</p> <p><b><i>Kriteri i gjykimit (3.1)</i></b></p> <p>P. Evidenton kurrikula organizim të qartë të programit të ndarë në module sipas dy niveleve të trajnimit (fillestar/ dhe i avancuar)?</p> <p><u>Trajnimi bazë</u> (listimi i moduleve përkatës të njohurive fillestare/ose nivel të mesëm) <u>Trajnimi i avancuar</u> (listimi i moduleve)</p> <p>Siguron kurrikula dhënien e koncepteve thelbësore dhe të metodave që mundësojnë krijimin e ekspertizës së thelluar?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Janë të përshtatshme dhe koherente materialet e trajnimit?</li> <li>✓ Ju referohen standarteve, ose metodave/aplikimeve bashkëkohore, rregullave të përcaktuara në ligje/dhe rregullore respektivisht në fushën përkatëse (referenca me formate të miratuara)?</li> </ul>	

- ✓ Siguron kurrikula lidhje të rezultateteve të pritshme të trajnimit me objektat e programit të trajnimit?
- ✓ Vlerësimi mbi vlerësimin është i matshëm, formativ apo i shpejtë?

***Kriteri i gjykimit (3.2)***

Përcakton kurrikula grupin e synuar (target grup / ose audiencë) të programit të trajnimit?

Ofron kurrikula elementë të menaxhimit (psh menaxhimit operacional ose menaxhimit strategjik):

- ✓ Vlerësimin e ambjentit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatës;
- ✓ Vlerat e menaxhimit strategjik dhe procesin e planifikimit të menaxhimit strategjik (psh. planet e zhvillimit sektorial, planet e veprimt, indikatorët e matshëm të performancës SMART, matricën e monitorimit dhe përgjegjësitë e institucionit për monitorimin e arritjeve);
- ✓ Vlerat e institucionit;
- ✓ Krijimin e vizionit të institucionit, formulimin e misionit, faktorët kryesorë të suksesit, kompetencat dalluese (psh kompetenca të një pozicioni specialist vs. pozicionit nivel drejtuesi, palët e interesuara”, qytetarët, përgjegjësia sociale.

***Kriteri i gjykimit (3.3)*** Kriteri është opsional (nuk është objekt i vlerësimit me pikë; hartuesi i

	kurrikukës mund të sjelle koncepte/ ose elementë të “Sjelljes Organizative”, udhëheqjes, etikës profesionale në administratë.	
Konkluzione dhe Rekomandime:		
Standarti 4: Kurrikula është në përputhje me qëllimin dhe objektivat e trajnimit		
<p><b>Kriteri 4.1:</b> Formulimi i qëllimit në përputhshmëri me prioritetet e trajnimit dhe objektivate, si dhe rezultatet e pritshme.</p> <p><b>Kriteri 4.2:</b> Përshtatshmëria dhe strukturimi i moduleve në raport me objektivat.</p>	<p>Kurrikula duhet të evidentojë pesë elementë kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëllimi</li> <li>• Objektivat</li> <li>• Nevojat</li> <li>• Rezultatet</li> <li>• Vazhdimësinë</li> <li>• Grupi i synuar</li> </ul> <p><b><i>Kriteret e gjykimit:</i></b>  4.1 dhe 4.2 Specifikimet e kurrikules dhe standardet e syllabusit. Këto specifikime duhet të kenë një format të përbërë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Formulimi i Qëllimit dhe Objektivate;</li> <li>✓ Përmbledhje e programit dhe rezultatet e synuara (rezultati i pritur në fund të trajnimit) duke ju referuar objektivate te trajnimit (4.2)</li> </ul>	

Konkluzione dhe Rekomandime:		
<b>Standarti 5:</b> Kurrikula përmban elementë të barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit në vendin e punës (gender balance).		
<p>Kriteri 5.1: Promovimi i barazisë gjinore</p> <p>Kriteri 5.2: Politikat dhe praktikat kundër diskriminimit</p>	<p>Për të vlerësuar këtë Standart është caktuar si vlerësimi mbi përfshirja e elementeve të barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit. Kjo nënkupton përmban kurrikula elementë që trajtojnë çështjet e barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit në vendin e punës. Për shembull, leksione mbi praktikën e drejta të punësimit, menaxhimin e diversitetit dhe krijimin e një mjedisi pune gjithëpërfshirës. Për të vlerësuar këtë standart janë caktuar dy kritere: (1) Promovimi i barazisë gjinore; dhe (2) Politikat dhe praktikat kundër diskriminimit.</p> <p>Kurrikula do të vlerësohet në pikpamjet e përmbajtjes së saj ku promovohen njohuritë mbi zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe praktikave që mbështesin barazinë gjinore në vendin e punës, mënyrat e krijimit dhe zbatimit të politikave kundër diskriminimit që mbrojnë të gjithë punonjësit nga çdo formë e diskriminimit, qoftë ajo bazuar në gjini, racë, etni, aftësi të kufizuara, apo ndonjë karakteristikë tjetër, masat për të siguruar një mjedis pune përfshirës, ku të</p>	

	gjithë punonjësit ndihen të vlerësuar dhe të respektuar, dhe ku diversiteti shikohet si një burim force dhe inovacioni për organizatën	
Konkluzione dhe Rekomandime:		
<b>Standarti 6:</b> Kurrikula përmban elementë të ekonomisë qarkulluese (recycle economy).		
<p>Kriteri 6.1: (1) Menaxhimi i burimeve dhe reduktimi i mbetjeve</p> <p>Kriteri 6.2: Dizajni i qëndrueshëm dhe qarkullimi i produkteve</p>	<p>Për vlerësimin e këtij kriteri do të gjykojmë nëse <b>kurrikula e hartuar plotëson kushtet e ekonomisë qarkulluese që synon minimizimin e mbetjeve dhe maksimizimin e përdorimit të burimeve</b> Për të vlerësuar cilësinë e kurrikulave sipas standartit të gjashtë janë caktuar dy kritere që qëndrojnë në themel të ekonomisë qarkulluese: (1) Menaxhimi i burimeve dhe reduktimi i mbetjeve; (2) Dizajni i qëndrueshëm dhe qarkullimi i produkteve. Duke mbajtur në konsideratë këto kritere kurrikula e trajnimit vlerësohet në ato aspekte të përmbajtjes që theksojnë rëndësinë e përdorimit të burimeve në mënyrë më efikase dhe të qëndrueshme. Kjo përfshin planifikimin dhe implementimin e politikave që promovojnë riciklimin, ripërdorimin dhe reduktimin e materialeve dhe energjisë të përdorura në proceset publike dhe shërbimet, promovimin e politikave që mbështesin</p>	

	inovacionin në sektorin publik dhe privat për të krijuar produkte që kanë një jetëgjatësi më të gjatë dhe ndikim minimal në mjedis.	
Konkluzione dhe Rekomandime:		
<b>Standarti 7:</b> Kurrikula përmban elementë të qeverisjes së mirë.		
<p>Kriteri 7.1: Transparenca dhe Llogaridhënia;</p> <p>Kriteri 7.2: Pjesëmarrja dhe Përfshirja e qytetarëve</p> <p>Kriteri 7.3: Efikasiteti dhe Efektiviteti.</p>	<p>Ky Standart bazohet në vlerësimin e tre kritereve të përmendur: (1) Transparenca dhe Llogaridhënia; (2) Pjesëmarrja dhe Përfshirja e qytetarëve dhe (3) Efikasiteti dhe Efektiviteti.</p> <p>Vlerësimi i cilësisë duke u kryer bazuar në këto kritere synon të evdientojë nëse kurrikula thekson rëndësinë e veprimet transparent dhe të hapur të qeverisjes. Kjo përfshin procedura të qarta për vendimmarrje, akses të lehtë në informacione publike dhe komunikim të hapur me qytetarët. Kurrikulat e trajnimit duhet të sjellin në fokus mekanizmat e llogaridhënies, duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e performancës së punonjësve publikë, raportimin e rregullt të progresit dhe mbajtjen e përgjegjësisë për veprimet dhe vendimet e marra. Kurrikulat duhet të përfshijnë mënyrat se si</p>	

	<p>administrata publike mund të nxisë dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe të mbulojnë metodat dhe praktikat për të përdorur burimet publike në mënyrë optimale dhe për të përmirësuar proceset e punës për të arritur rezultatet më të mira me kosto më të ulëta.</p>	
<p>Konkluzione dhe Rekomandime:</p>		
<p>Standarti 8: Kurrikula ka konceptim didaktik</p>		
<p><b>Kriteri 8.1:</b> Janë të përcaktuara qartë modulet dhe ngarkesa e tyre relative (Plani Mësimor) (jepen elementë sqarues si raporti ‘ore trajnimi’/pune në grup, ose punë e pavarur, shpërndarja e temave (programi), formati i mësimdhënies, gjuha e kuptueshme).</p>	<p><b>Kriteri i gjykimit (8.1):</b> Në çfarë niveli kurrikula përmban elemente si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Struktura e kursit/trajnitimit (në formën e rregulloreve të miratuara të programit, metoda e mësimimit);</li> <li>✓ Matricë aftësish (si rezultatet e synuara të të nxëniet janë dorëzuar përmes moduleve thelbësore që përbëjnë programin);</li> <li>✓ Specifikime të modulit, orët në total të modulit, koha në auditor (teorike), orët e punës në grup (ose raste studimore nga praktika në një institucion);</li> <li>✓ Informacion në lidhje me mënyrën si një modul duhet mësuar dhe vlerësuar dhe rezultatet e synuara të të mësuarit për pjesëmarrësit.</li> </ul>	

<p><b>Kriteri 8.2:</b> Struktura jep mundësi të mjaftueshme për studim të pavarur dhe reflektim/analizë (opsionale/plotësuese, ose me dëshirë nga pjesëmarrësi në trajnim)</p> <p><b>Kriteri 8.3:</b> Metodatat e përdorura janë në përputhshmëri me audiencën, janë fleksibël, interaktive, inovative dhe tërheqëse për grupin e synuar (audiencën), dhe mundëson identifikimin e nëpunësve/ose personave të jashtëm të talentuar.</p>	<p>✓ Referencat e literatures (literatura, referenca në publikime/materiale të 10 viteve të fundit të jenë të aksesueshme; Literatura të përmbajë jo vetëm titujt e librave ose shkrimeve por <i>mundësisht</i> dhe ekstrakte të tyre, si dhe cilat faqe duhet të studiojë i trajnuari.</p> <p><b>Kriteri i gjykimit (8.2):</b> Ky kriter mund të jetë plotësues, i cili nxit studimin e pavarur, reflektimin/ dhe analize për një risi (metodë të re) që mund të sjellë nëpunësi civil / ose punonjësi i administratës publike lidhur me ndryshimin e përfaqësues së punës ose të menaxhimit në institucionin ku punon.</p> <p><b>Kriteri i gjykimit (8.3):</b> Në çfarë mase kurrikula i përshtatet audiencës, ofron opsione të metodave të trajnimit (fleksibilitet, ndërveprim, diskutim (ose debat), punë në grup, lojë me role, vizita studimore në institucione të fushës, biseda me zyrtarë të ftuar nga ndonjë institucion qëndror duke siguruar shkëmbim të njohurive/praktikave. <i>Për trajnimin e thelluar / dhe të vazhduar</i> përshkrimi duhet të sigurojë specifikime si leksionet (pjesën teorike në sallën e trajnimit), demonstrime, raste reale për studim nga realiteti i punës së NJQV), debate, diskutime në grup të madh, pune e pavarur individuale/punë në grupe të vogla, prezantim të punës në grup të vogël, lojë me role, vizita studimore në ndonjë institucion qëndror (relevant), biseda me të ftuar.</p>	
---	---	--

	<p><i>Për trajnimin e vazhdueshëm</i>  Konsultim nëpërmjet takimeve me të trajnuarit /dhe nëpërmjet internetit.  Përdorimi i mjeteve audiovizive</p>	
Konkluzione dhe Rekomandime:		
Standarti 9: Format e Vlerësimit		
<p>Kriteri 9.1: Vlerësimi/ Testimi  (mundëson sigurimin e qënrueshëm dhe nivel me të mirë të dijeve dhe kompetencave profesionale të zhvilluara nëpërmjet trajnimit)</p>	<p><b><i>Kriteri i gjykimit:</i></b>  ✓ Testi final dhe pikët për çdo lloj testimi (rezultati përfundimtar).   (opSION: testi final 60 pikë; testi ndërmjetës (40 pikë (nëse do të ketë test të ndërmjetës), aktivizimi në grup/ose punë individuale 20 pike)  Psh: Shpjegon kurrikula mënyrën e vlerësimit/testimit?  Ofron modele të testeve paraprake? Jep informacion indikativ mbi kohëzgjatjen e testit, skemën e vlerësimit (psh. vlerësim të testit me shkrim, ose vlerësim të punës individuale, ose punë në grup)?</p>	

Konkluzione dhe Rekomandime:

(vleresim bazuar ne komente)